



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Fakulteti i Shkencave Humane, shpall konkurs për personel ndihmësakademik me kohë të plotë, specialist në laboratorin e medias.

Personeli ndihmësakademik, specialist në laboratorin e medias, është anëtar i njësisë së laboratorit të medias, pjesë e Fakulteti të Shkencave Humane dhe merret me organizimin e punës në realizimin e detyrave dhe funksionimin e laboratorit të medias; bashkëpunon me anëtarët e tjerë të njësisë si dhe strukturat përbërëse të Fakultetit në realizimin e procesit mësimor e më gjërë; raporton periodikisht te prorët.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master) ose ekuivalente me të në fushën e shkencave humane. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij/saj të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i/e aftë për punë.

Kritere të veçanta:

- Të ketë përvojë të mëparshme pune administrative.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese.
- Të jetë njohëse dhe përdoruese e kompjuterit.
- Të jetë njohës i një gjuhe të huaj perëndimore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**27.11.2023 – 12.12.2023**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës specialist në laboratorin e medias në Fakultetin e Shkencave Humane.
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënësi apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (27.11.2023 – 12.12.2023) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani",
Rruga "Ismail Zyma",
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist në laboratorin e medias.*
Elbasan

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit të Shkencave Humane**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtrohen intervistës me gojë brenda periudhës (14.12.2023 – 22.12.2023). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës si dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.